



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of lokal government Administration

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149, shpall :

KONKURS

Titulli i postit: Zyrtar për Leje të Ndërtimit

Njësia: Drejtorati për Planifikim Hapësinor, Kadaster dhe Inspektion, Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut (ZAMV)

Niveli i pagës/gradës :

Orari: 40 orë në javë

Raporton tek: Drejtori i Drejtoratit për Planifikim Hapësinor, Kadaster dhe Inspektion, ZAMV

Referenca:

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Përpunon kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcakton kushtet urbanistike, të lejes urbane për zbatimin e planit hapësinor, PZHU, PRRU, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit
2. Shqyrton procedurat e dhënies së lejeve të ndërtimit, lejet e përdorimit dhe të shfrytëzimit , lëshon leje për rrënim të objekteve;
3. Mban shënimet mbi dhënien e tokës sipas destinimit të përcaktuar me

planin gjegjës;

4. Mban shënimet mbi llojin, përmbajtjen dhe kapacitetet e objekteve të planifikuara;
5. Mban shënimet mbi pozitën e objekteve në ngastrën ndërtimore, respektivisht mbi karakteristikat e tyre niveluese dhe rregulluese;
6. Projekton kushtet për projektimin dhe ndërtimin e sipërfaqeve të rrugëve dhe sipërfaqeve të lira gjelbëruese në kuadër të ngastrave ndërtimore;
7. Projekton kushtet teknike për lidhjen e objekteve të reja në rrjetin e infrastrukturës ekzistuese dhe kushtet e tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin racional të energjisë;
8. Përpilon kushtet për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kushtet për mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare, kushtet për ndërtimin e objekteve të mbrojtjes civile, kushtet për mbrojtjen, ruajtjen dhe konservimin e vlerave kulturore dhe natyrore, kushtet për lëvizjen pa pengesa të personave me aftësi të kufizuara;
9. Përpilon kushte të tjera të cilat, në rastet e caktuara, janë me rëndësi për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve dhe të tokave të planifikuara;
10. Harton pëlqimin e rregullimit të infrastrukturës, lëshimin e lejeve ndërtimore në infrastrukturë: si ndërtimi i rrugëve, kanalizimeve fekale dhe atmosferike, ujësjellësve, rrymës, elektrike, PTK etj,
11. Hartimin e planit për vendosjen dhe ndërtimin, si dhe cakton kushtet e objekteve me karakter të përkohshëm në përputhje me ligjin dhe vendimet e aplikueshme dhe mban evidencën e tyre.
12. Siguron lidhjen e kontratave mbi dhënien me qira të tokës ndërtimore;
13. Përgatit raporte për Drejtorin;

Kryen të gjitha detyrat që i jepen nga Drejtori i Drejtoratit;

Aftësitë dhe shkathtësitë:

- Shkathtësi të dëshmuara në të menduarit strategjik, aftësi të planifikimit, shkathtësi në aplikimin e planeve dhe punës në grup;
- Aftësi për punë në mjedis multi-etnik;
- Aftësi për punë nën presion;

- Aftësi të mira ndër njerëzore dhe mbajtja e kontaktit me personat të cilët marrin vendime;
- Njohja e gjuhëve zyrtare, ndërsa njohja e gjuhës angleze do të merret si përparësi;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikimi;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë Universiteti-fakulteti në lëmin e Arkitekturës, Ndërtimatarisë apo fusha tjera relevante.
- Njohja e programeve zhvillimore të Komunës dhe zbatimi i tyre;
- Përvojë pune në fushat relevante, preferohet te ketë përvojë pune menaxheriale;
- Njohuri bazike mbi legjislacionin e pushtetit lokal dhe fushës profesionale;
- Aftësi të mira të punës me kompjuterë (me aplikacionet Microsoft, internet etj.);

Procedura e aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren në Zyret e Ekipit Pergaditor per Mitrovicën e Veriut dhe Qendrën për Shërbime të Qytetarëve në Lagjen e Boshnjakëve ose në adresën elektronike <http://kk.rks.gov.net/mnao/> Numri kontaktues 038-200 35 084; 038/200 35 082 prej orës 08:00 deri 16:00, çdo ditë pune.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën, certifikata e shtetësisë dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkojnë për vendin e punës për të cilin konkurroni. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur në listën e ngushtë dhe të ftuar në intervistë doemos duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale si dhe të kenë me vete kartën e identitetit (letërnjoftimin).